

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.

Nr. ____ Prot

Data _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Ndërtimi i Kolektorit Kryesor të Kanalizimeve dhe Impiantit të Trajtimit të Ujrave Të Ndotura Maliq.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):): 45247130-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 123,593,424.32 *(njqind e njezet e tre milion e pesqind e nentedhjete e tre mije e katerqind e njezet e kater pike tridhjete e dy), Leke pa TVSH .*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, njësia e prokurimit harton procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në lidhje me përcaktimet në VKM Nr.285/2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 45 ku kërkohet “Në rastin kur oferta ekonomike më e favorshme identifikohet në bazë të kostos, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e një pasnjëshëm., do të jenë si më poshtë:

Së pari në DT **Kapitulli 4.4** “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” Autoriteti Kontraktor gjykoj që të vlerësohet mbi bazën e Ofertës ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto: **X**

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomisht më e favorshme, bazuar në kosto ¹ x

Sipas rëndësisë:

Çmimi □	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit □ □	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanise □ □	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social □ □	pikët 10
Periudha e garancisë së objektit □ □	pikët 5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{maxk1} Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkrimore dhe grafike) kohën e propozuar (**jo më shumë se 6 muaj**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

¹Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Nënkriteri:

- a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]
- I. Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 15 dite): [2 pike].
 - II. Grafiku i punimeve te Kontratës. [13 Pike]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{mink2a} \times P_{maxk2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a}	Pikët e kriterit që vlerësohet
V_{mink2a}	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
P_{maxk2a}	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k2a}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- b) Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Stafi / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Kualifikimi i stafit Kyc dhe eksperiencia ne fushen specifike [13 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve me poshte:

- I. Dëshmi që stafi disponon diplome universitare [6 pike]
- II. Dëshmi që stafi disponon pune te ngjashme me objektin e prokurimit [4 pike]
- III. Dëshmi që stafi disponon experience mbi 1(nje) vit pune [2 pike]
- IV. Dëshmi që stafi disponon eksperience ne natyre/kompleksitet te ngjashme me kontraten e prokurimit. [1 pike]

Per permbushjen e kritereve te mesiperme duhet te dorezohet CV dhe deshmi/reference/dokumentacion te leshuar nga punedhenes te meparshem ose perfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

*Shenim: Per permbushjen e kriterit te mesiperm operatori ekonomik duhet te dorezoje organigramen e propozuar te stafit qe do te operoje ne ekzekutimin e kontrates, metodologjise te nderveprimit midis strukturave me njera-tjetren, me mbikeqyresin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh perbejne sistemet e brendshme te kontrollit dhe menaxhimit te cilesise.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vleresimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k5}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k5}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k5}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

***Shënim – Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kritereve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret) duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.**

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, me vlerë 2,471,868 (*dy milion e katerqind e shtatedhjetë e një mijë e teteqind e gjashtedhjetë e tete) Leke.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë MIE/ ose MPPT/ ose MTI, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT

- a. NP – 1 A (Punime gjurmimi në tokë)
- b. NP – 2 B (Ndërtime civile dhe industriale)
- c. N.P – 7 C (Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje)

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- a. N.S. – 18 B (Punime topogjeodezike)
- b. N.S. – 21 A (Impiante të trajtimit të ujërave të zeza)

Argumentimi: Kategoritë e kërkuara të licencës janë në përputhje dhe në proporcion me natyrën dhe volumin e punimeve objekt prokurimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar. Të dhënat për licencën e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 i cili përcakton se "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridike, private ose publike, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe

produkteve te ndertimit, te cilat duhet te plotesojne kerkesat e projektit ne perputhje me standartet kombetare ose europiane.

AK vlereson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivele të kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës. Llojet e licencave dhe niveli i klasifikimit të tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përllogaritur sipas preventivit të hartuar për kë të objekt.

Niveli i klasifikimit për kategoritë respektive është kërkuar duke u bazuar në zëra të punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, si me poshte :

Kategoritë e licencave me sipër teknikisht argumentohet:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorise sipas legjislacionit te fushes</i>	<i>Niveli i klasifikimit te kerkuar per kategorine respektive</i>	<i>Vlera e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv, qe perfshihen ne kategorine perkatese</i>
NP- 1A	Punime gërmimi në tokë	0-20 milion leke	Nuk kalon 20 milion leke
NP-2B	Ndërtime civile dhe industriale	21- 50 milion lekë	Nuk kalon 50 milion leke
NP-7C	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje”	51 – 100 milion lekë	Nuk kalon 100 milion leke
NS– 21A	Impiante të trajtimit të ujërave të zeza	0- 20 milion lekë	Nuk kalon 20 milion leke
NS-18-B	Punime topogjeodezike	21- 50 milion lekë	Nuk kalon 50 milion leke

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Neni 39, pika 6/a, e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për çdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë

përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

N.P-1A Punime gjurmimi në tokë: Në preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gjurmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-2B Ndërtime civile dhe industriale: Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse. Në preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndërtimin, mirëmbajtjen dhe ristrukturime, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses të kontratës. Konkretisht në seksionin Shuma 4 përkrahë zerat e punimeve që kanë lidhje me këto kategori licence.

N.P-7 C Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje: Kjo kategori punimesh është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit. Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen direkt me kanalizimet, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë N.P-7 , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S-21 A Impiante të trajtimit të ujërave të zeza. Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja, ristrukturimi i impianteve të ujërave të zeza që duhen trajtuar, kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet. Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me Punime të trajtimit të ujërave të zeza, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Konkretisht në seksionin shuma 4 dhe shuma 5 përkrahë zerat e punimeve që kanë lidhje me këto kategori licence.

NS-18-B Punime topogjeodezike: Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen Punime topogjeodezike, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Kërkesa për licencë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve, të cilat kërkojnë pikturim, nivelim dhe kontroll të saktë gjeometrik gjatë zbatimit të projektit ujesjellesit dhe linjave të tij. Kjo licencë garanton kapacitetet teknike për realizimin korrekt të punimeve dhe përputhshmërinë me projektin.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore gjatë tre viteve 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën në një nga vitet e periudhës së kërkuar të jete sa vlera e përlogaritur e kontratës. Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim nga Dega e Tatim-Taksave ose vërtetim elektronik nga shërbimet e-Albania.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilancit për tre vitet 2023, 2024 dhe 2025 të paraqitura dhe konfirmuara pranë autoriteteve përkatëse tatimore, me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt - Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, ne rast se plotësohen kushtet e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, kreu V, neni 41, pika c. *Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77, pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik ku përcaktohet se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në :* b) *gjendjen ekonomike dhe financiare ;...* 3) Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Përmiratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet: “Autoritetit kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3(tre) vitet e fundit financiare.” Ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Nëse vlerësohet, Autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vite të fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Gjithashtu, për caktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht:

Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat ”, i ndryshuar pika 3.12 etij, dhe kërkesave të **Ligjit Nr.25 datë 10.05.2018** “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare ” neni 9 i tij ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1

janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përfundimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat”.

Ligji Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” gjykojmë që të kërkojmë xhiron vjetore dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2021,2022,2023) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Komisioni përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qenë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme sipas percaktimeve të nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 i ndryshuar si më poshtë:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:

- Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:

- a) Kontratën e Sipërmarrjes,
- b) Situacionin përfundimtar të objektit
- c) Aktin e Kolaudimit të objektit
- d) Formular Vlerësimi

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

- Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:

- a) Kontratën e Sipërmarrjes,
- b) Situacionin përfundimtar të objektit
- c) Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d) Aktin e Kolaudimit të objektit

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.

Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se:“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burime të nevojshme njerëzore e teknike,si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore,në veçanti,mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 te VKM Nr. 285 datë 19.05.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme,autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit,nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b)punë të ngjashme deri në një kufi,ku vlera monetare totale e punëve të kryera,e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit,është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/entikontraktor,si dëshmi për përvojën e mëparshme,kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës,ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti /enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime,për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera,afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi ,që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor,përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Autoriteti Kontraktor përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës. **Përvoja te mëparshme** janë element shumë i nevojshëm,që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kriteri kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë.

Referuar këtij neni, AK vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM të dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacioni të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin edhe situacionet përfundimtare dhe formular vleresimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punime te mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zëra te punimeve që po prokurohen. Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët

ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), AK gjykon se kërkitimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Ndërsa me ndryshime të reja ligjore përkatësisht VKM Nr. 498, datë 01.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021, Neni 16 ku parashikohet “Në paragrafin e fundit, të pikës 5, të nenit 39, “Kërkesatë veçanta për kontratat për punë publike”, pas fjalëve “...”, e shoqëruar me fatura tatimore...” shtohen “...**të deklaruara në organet tatimore...**” u kërkuar që në kërkesën e bërë përpunime të ngjashme të kryera dhe të realizuara me sektorin privat si dëshmi përpërvijën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, të paraqiten vërtetime të shoqëruara me faturat tatimore të shitjes, të deklaruara në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat, natyra e punës së kryer dhe situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- b. 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- c. 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
- d. 1 (një) Inxhinier Mjedisi i Profili Trajtim Ujrash

2.3.3. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- b. 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- c. 1 (një) Inxhinier Gjeodet / Topograf / Markshajder
- d. 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (profili Infrastruktura ose Strukturist)
- e. 1 (një) Inxhinier Mekanik
- f. 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.2 dhe 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Diplomë
- CV
- Kontratë pune
- Listpagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën Prill-Maj-Qershor 2026

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor dhe atë mbështetës në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Inxhinier Ndërtimi: Referuar preventivit dhe projektit të punimeve është e nevojshme prezenca e Inxhinierit të Ndërtimit. Kërkohet për drejtimin teknik të punimeve civile të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit, duke garantuar zbatimin korrëkt të projektit dhe cilësinë e punimeve.

Inxhinier Hidroteknik: Referuar preventivit dhe projektit të punimeve është e nevojshme prezenca e Inxhinierit Hidroteknik. Kërkohet për drejtimin teknik të punimeve civile të punimeve Hidroteknike, analizimin e projektit, duke garantuar zbatimin korrëkt të projektit dhe cilësinë e punimeve.

Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/: Referuar preventivit dhe projektit të punimeve është e nevojshme prezenca e **Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder**. Kërkohet për drejtimin teknik të punimeve civile të punimeve topografike, analizimin e projektit, duke garantuar zbatimin korrëkt të projektit dhe cilësinë e punimeve.

Inxhinier Mjedisi i Profili Trajtim Ujrash: Referuar preventivit konkretisht zerave të cituar në shumen 4 dhe 5 dhe projektit të punimeve është e nevojshme prezenca e Inxhinierit të Mjedisit profil Trajtim Ujrash. Kërkohet për drejtimin teknik të punimeve lidhur me trajtimin e ujrave, analizimin e projektit, duke garantuar zbatimin korrëkt të projektit dhe cilësinë e punimeve.

Inxhinier Ndërtimi (profili Infrastruktura ose Strukturist): Referuar preventivit konkretisht zerave të cituar në shumen 4 është e nevojshme prezenca e një inxhinieri nderimi me profil infrastrukturë ose strukturist.

Inxhinier Mekanik do të jetë përgjegjës për punimet mekanike ekzistuese në objekt sipas preventivit të punimeve.

Inxhinieri i Ndërtimit profili gjeoteknik: studion vetitë mekanike të tokës dhe përcakton zgjidhjet më të përshtatshme për themelin e veprës së mbledhjes së ujërave të zeza, në mënyrë që të shmangen deformimet, uljet apo çarjet të tokës gjatë ndërtimit të veprës dhe hapjeve të kanaleve për vendosjen e tubave të kanalizimeve. Ky inxhinier është përgjegjës për zbatimin e testeve gjeoteknike dhe për të përcaktuar përshtatshmërinë e vendit për ndërtim. Testet ofrojnë të dhëna të çmuara mbi vetitë fizike dhe mekanike të dheut, duke përfshirë llojin, fortësinë, densitetin, përshkueshmërinë, porozitetin dhe kompaktimin, ndër të tjera.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet te disponoje një “Kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurinë dhe shëndetin në punë" i ndryshuar dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 i ndryshuar "Per miratimin e rregullores "Per sigurinë ne kantier". Për të deshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomike duhet te paraqesin dokumentacionin si me poshte:

- Diplome universitare në inxhinieri ose arkitekturë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi ose certificate që tregon pjesëmarrjen në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private në përputhje me kërkesat e parashikuara në V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 i ndryshuar "Per miratimin e rregullores "Per sigurinë ne kantier".
- CV
- Kontratë pune
- Listpagesat e sigurimeve shoqerore dhe shëndetësore per periudhën Prill-Maj-Qershor 2026

Kriteri në fazën e dorëzimit të ofertave konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet te permbajë kërkesat e autoritetit.

Autoriteti/enti kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me anë te këtij kriteri kërkohet qe operatorët ekonomike të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mesiperme mbështet ne ligjin Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per siguri dhe shendetin ne pune" i ndryshuar dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 Per miratimin e rregullores "Per siguri ne kantier" i ndryshuar . Natyra e kontrates dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e pergatitje te posacme per vleresime te përpikta për të zgjidhur çështje qe lidhen me garantimin e siguri dhe mbrojtjen ne pune. Ne rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 eshte percaktuar se punedhenesi per mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziket, duhet te ndjeke kurse formimi perkates ne fushen e sigurise e te shendetit ne vendin e punes. Cdo punedhenës zgjedh nje ose disa persona si pergjegjes per ndihmën e pare në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja percakton kërkesat minimale te siguri dhe ëe shendetit në punë për kantieret e përkohshem ose te lëvizshëm, si dhe masat e pergjithshme te mbikeqyrjes. Garantimi i ekspertizes se mbrojtjes nga cdo rrezik dhe te papritur ne pune dhe dokumentat perkatese te personave pergjegjes i sherbejne autoritetit per te krijuar bindjen dhe besueshmeri per realizimin e kontrates. Pergjegjes per siguri dhe mbrojtjen e shendetit ne pune rekomandohet te jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate nga Administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik të Punimeve ne objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçensën e shoqërisë, do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Vendimi nr. 448, datë 31.07.2025 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit” ku përcaktohet se: “1. Detyra e drejtuesit teknik të zbatuesit të punimeve është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës. 2. Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i zbatuesit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, KREU IV pika 2, germa b) ku përcaktohet: Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi si drejtues teknik dhe ndalohet të disponojë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit; dhe KREU III, pika 3, germa “c” ku përcaktohet se: “Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paafësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë 1(nje) punojës i cili të jetë i pajisur me certifikatë **“Ekspert Zjarrfikës”** ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me nenin 49 pika 4 te Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin". Për të deshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomike duhet te paraqesin:

- Kontratë individuale pune të vlefshme,
- Diplome/certifikate,
- Listëpagesat e shoqërisë per periudhen Prill-Maj-Qershor 2026.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kriteret e percaktuara ne piken 2.3.5 dhe 2.3.6 në fazën e dorëzimit të ofertave konsiderohen te përmbushura me vetedeklarimin sipas Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhe te permbajë kërkesat e autoritetit.

Autoriteti/enti kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Ekspert Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin“, ku citohet se : ”Drejtorja e Përgjithshme e MZSH-së jep

certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e **1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.**

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë:

- 4 (katër) Hidraulikë
- 4 (katër) Karpentierë
- 4 (katër) Hekurkthyes
- 1 (një) Teknik ndërtimi
- 1 (një) Teknik mekanik
- 1 (një) Hidroizolues
- 1 (një) Saldator
- 18 (tetëmbëdhjetë) punëtorë krahu

Për të deshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomike duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma/certifikata përkatëse të arsimit profesional, që vërteton nivelin e kualifikimit profesional, lëshuar nga institucione publike/private, të licencuara/akredituara, të njohur nga Republika e Shqipërisë, sipas Ligjit Nr.15/2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë*” ose ekuivalente.
- Dëshmi kualifikimi për Sigurimin Teknik
- Listpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Prill-Maj-Qershor 2026

Për 18 punëtorët e krahut duhet të paraqiten vetëm kontratat e punës të vlefshme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kriteri në fazën e dorëzimit të ofertave konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Permbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që

do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuar në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme). Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të Projektit të punimeve:

- **Hidraulik:** Të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e të gjitha punimeve hidraulike, sipas preventivit ku këto punime zënë pjesë të konsiderueshme, si furnizim vendosje tuba dhe rakorderi, punimet për rrjetin, punimet për puseta etj.
- **Karpentierë:** Të nevojshëm për ndërtimin e formave për beton, montimin e elementëve druri dhe strukturave të përkohshme, të cilat mbështesin punimet betonit sipas zërave të preventivit.
- **Hekurkthyes:** Për prerjen, përgatitjen dhe vendosjen e hekur, pjesë thelbësore e punimeve beton arme.
- **Teknik Ndërtimi:** Kërkohet për ndjekjen e punimeve ditore në terren, organizimin e ekipeve të punës dhe zbatimin korrekt të udhëzimeve të inxhinierëve, duke garantuar cilësinë dhe rendin në punime.
- **Teknik mekanik:** Kërkohet për ndjekjen e punimeve ditore në terren, organizimin e ekipeve të punës dhe zbatimin korrekt të udhëzimeve të inxhinierëve, duke garantuar cilësinë dhe rendin në punime.
- **Hidroizolues:** të cilët do të realizojnë punimet sipas preventivit për hidroizolim të vepres.
- **Saldator:** Për punimet e saldimit, pjesë e projekt preventivit
- **Punëtorë krahu:** Për ndihmë në transport materiale, mbajtje rendi në punime, dhe aktivitetet ndihmëse të nevojshme për realizimin e kontratës, duke mbështetur ekipet teknike dhe specialistët.

Prezenca e këtyre punonjësve në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të kualifikuar** për kryerjen e punimeve, të cilët duhet të jenë të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale, që të vërtetojë kualifikimin profesional, sipas profileve të më poshtme:

- **Manovrator(ekskavatorist/automakinist) 2 (dy)**
- **Shofer kamjoni 1 (një)**

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Dëshmi të Aftësisë Profesionale, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për

punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjistikës dhe referuar Kodit Rrugor.

- Listpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Prill-Maj-Qershor 2026

Për Manovratorin (ekskavatorist/automakinist) dhe Shoferin e kamionit të kërkuar sa më sipër, kur mjetet disponohen me qira operatori ekonomik mund ti disponojë ato nëpërmjet kontraktimit, së bashku me mjetet e mara me qira, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kriteri në fazën e dorëzimit të ofertave konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Permblidhes të Vetedeklarimit, sipas shtojces nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Kjo kërkesë është kërkuar që të sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike. Numri dhe kualifikimi i punonjësve të paraqitur në këtë ofertë është përcaktuar në përputhje me mjetet dhe makineritë e deklaruar për realizimin e kontratës. Çdo mjet i parashikuar shoqërohet me personelin përkatës teknik të nevojshëm për operimin e tij, duke garantuar funksionim të pandërprerë dhe efikas gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve. Konkretisht, numri i shoferëve, manovratorëve, është dimensionuar mbi bazën e numrit dhe llojit të makinerive të angazhuara, për të përballuar ngarkesën e punës dhe çdo situatë operative.

Kjo qasje garanton një shpërndarje optimale të burimeve njerëzore në raport me kapacitetet teknike, duke rritur sigurinë, cilësinë dhe efikasitetin e realizimit të punimeve në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Prandaj, vendosja e këtyre kriterëve në dokumentet e tenderit synon të sigurojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të kenë kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin me sukses të projektit.

2.3.9. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **50 persona**. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vertetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 muajore nga momenti i hapjes së ofertave (Prill-Maj-Qershor 2026).
- Listpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Prill-Maj-Qershor 2026).

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kriteri në fazën e dorëzimit të ofertave konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet te permbajë kërkesat e autoritetit.

Autoriteti/enti kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumenteve provuese.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohë është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përfshijet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim mesatarisht të paktën 50 duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Vendosja e kriterit për një punësim mesatarisht të paktën 50 punonjes duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementet e struktura të kostos (material, puntori, makineri, transport). (Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, I ndryshuar dhe akteve nënligjore.

2.3.10. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Statusi	Sasia
Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
Eskavator me zinxhire	në pronësi ose me qira	Copë 1
Fadrome me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
Minifadrome me goma(bobcat apo ekuivalente)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes nga 10 deri 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
Kamion me vinç	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamionçinë me kapacitet mbajtes deri në 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
Autobot Uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
Motobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
Pompe Uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
Vibrator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Motogjenerator / Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kompresor ajri	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kontenier ndertimi (zyre) e levizshme	në pronësi ose me qira	Copë 1
Tokmak elektrik	në pronësi ose me qira	Copë 1
Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
Rul	në pronësi ose me qira	Copë 1
Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 1
Rimorkiator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Fabrikë betoni pajisur me lejë mjedisore	në pronësi ose me qira	Copë 1
Dumper	në pronësi ose me qira	Copë 1

Per te provuar permbushjen e ketij kriteri operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte:

- Për mjetet ne pronesi që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit: leje qarkullimi; certifikaten e kontrollit teknik; siguracionin e mjetit, (i vlefshëm), foto te mjetit.
- Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: kontrata perkatese e qerases e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; leje qarkullimi; certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(i vlefshëm), foto te mjetit.

Autoriteti Kontraktor UKKO SH.A rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara nga OE.

Kriteri në fazën e dorëzimit të ofertave konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Permblledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet t te permbajë kërkesat e autoritetit.

Autoriteti/enti kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Te gjitha mjetet jane vendosur ne perputhje me zerat e preventivit per realizimin me sukses te tyre. Konkretisht eskavatoret, fadromat minifadroma minieskavatore jane te lidhura me procese pune si germimet dhe heqjen e materileve te ndertiimit. Kamionat dhe kamioncinat jane vendosur ne perputhje me zerat e preventivit per transportin e materialeve si zhavor, rere, transport punetoresh , vegla pune e keshtu me radhe dhe autopompa e betonit autobetoniere autobot uji te nevojshme per hedhjen e betonit, transportin e betonit, sperkatjen me uje te shtresave etj. Po keshtu edhe sa i takon mjeteve grejder, rul, matrapik te cilat jane te nevojshme per realizimin e punimeve.

2.3.11. Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme te akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë si me poshte:

- a) Certifikatën per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001:2018** e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- d) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 3834-2:2021**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Cilesise ne Saldim e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar.

Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.10 gërma “a”- e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 / ekuivalente është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 / ekuivalente ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018/45001-2023 / ekuivalente është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 ose ISO 45001-2023 ose me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

EN-ISO 3834-2:2021/ ekuivalente është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Çdo Ofertues që merr persiper punime saldimi, duhet të jetë i pajisur me EN-ISO 3834-2:2021 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (strukturat metalike ku ka edhe saldime), me ritjen e cilësisë së ndërtimit, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me EN-ISO 3834-2:2021/ekuivalente pasi materiali i dobët, i pasaktë dhe kushtet negative të saldimit krijojnë probleme serioze, të kushtueshme të cilat mund të çojnë në carje të nyjeve.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.12. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licence lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve” me **Kod III.2.B** së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, ose mund të paraqesin një **kontrate/marreveshje bashkepunimi** (te vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës sipas grafikut të punimeve) me operatore të licensuar për këtë shërbim.

Argumentimi: Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”. Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në Ligjin nr. 57 /2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 68, pika 2 dhe 3 parashikohet se: “2. Grumbullimi, transportimi, ruajtja, riciklimi, përpunimi, asgjësimi, tregtimi apo ndërmjetësimi për mbetjet kryhen nga persona që disponojnë licencën për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, me kodin III.2.B, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë. 3. Licenca për veprimtaritë e parashikuara në pikën 2 të këtij neni lëshohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore nga “Qendra Kombëtare e Biznesit”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Kërkesa që operatori ekonomik të jetë i licensuar me Kodin III.2.B është e nevojshme sepse gjatë ndërtimit të rrugës krijohen mbetje ndërtimore që duhet të menaxhohen në mënyrë ligjore dhe të kontrolluar.

Kodet e kërkuara lidhen specifikisht me zërat e punimeve, si punime gërmimi, prishje, pastrimi i pusëve dhe mbingritjen e tyre, zëra të cilat shkaktojnë mbetje. Kjo garanton që operatori ekonomik mund të grumbullojë

dhe transportojë ligjërisht mbetjet e ngurta të rrugës, duke përfshirë metalet e tabelave, betonin, tullat dhe mbeturinat e tjera të kantierit, duke siguruar siguri mjedisore dhe respektim të rregullave ligjore.

Kjo licencë garanton që operatori: respekton legjislacionin mjedisor; transporton dhe depoziton mbetjet në mënyrë të rregullt; shmang ndotjen dhe problemet për komunitetin dhe siguron organizim e siguri më të mirë në kantier.

2.3.13. Operatoret ekonomike për materialet **Tuba plastike HDPE te brinjezuar, Tuba dhe rakorderi inoksi, Rakorderi HDPE, Kapaket e gizes se pusetave**, të parashikuara në preventivin e procedurës së prokurimit, duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë:

- a) Autorizim Prodhuesi ose autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi i cili në rast duhet të tregojë lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit. Autorizimi/Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- b) Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

Kriteri në fazën e dorëzimit të ofertave konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Permbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar si e nevojshme pasi në objekt kemi të bëjmë me materiale (artikuj) që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nën 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre**, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementet më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve tubacione të ujësjellësit, që do të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe atë të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së artikujve të sipërcituar. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri

për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të Prodhuesit, Autoriteti ka mundësi të kontaktoje me Prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë. Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Vendosja e kriterit për **paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit** është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që Autoriteti të ketë një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave. Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

2.3.14. Operatori/et ekonomik ofertues duhet të paraqesë/in grafikun e punimeve sipas percaktimeve në dokumentat e procedurës së prokurimit.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin **15 pika 3/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: “**a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;**”, si dhe Neni 39, pika 3 e kësaj VKM-je.

Argumentimi i specifikimeve teknike

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË KANALIZIMEVE PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT

"NDËRTIMI I KOLEKTORIT KRYESOR TË KANALIZIMEVE DHE VEPRËS SË TRAJTIMIT TË UJRAVE TË NDOTURA MALIQ".

Zbatimi i punimeve të kanalizimeve të ujrave të përdorura në projektin:

"NDËRTIMI I KOLEKTORIT KRYESOR TË KANALIZIMEVE DHE VEPRËS SË TRAJTIMIT TË UJRAVE TË NDOTURA MALIQ" duhet të jetë në përshtatje të plotë me KTZ (Kushtet Teknike të Zbatimit) si dhe standartet për “Ndërtimin dhe provat e drenazheve dhe kanalizimeve të ujrave të përdorura”.

Hapja e kanalit ku do të vendosen tubacionet.

Kanali hapet në vijë të drejtë sipas drejtimit të përcaktuar në projekt. Thellësia e tij duhet të jetë jo më pak se 10 cm nën tubin që do të vendoset. Kanali pastrohet plotësisht dhe nuk duhet të ketë në të gurë ose mbetje të tjera

mekanike. Fundi i kanalit duhet të jetë i gjerë jo më pak se 60 cm plus diametrin e jashtëm të tubit. Këndi i ngritjes tërthore të kanalit mund të jetë deri në 15 gradë.

Në rastet kur thellësia e kanalit i kalon 1,5 m duhet që skarpatat anësore vertikale të përforcohen me kallëp mbrojtës provizor (metalik ose druri) për të shmangur çdo rrëshqitje të dheut gjatë punimeve.

Vendosja e tubove.

Para se të vendoset tubi në kanal, në bazën e tij duhet të hidhet 10 cm shtresë uniforme me rërë të imët. Mbi këtë shtresë vendoset tubi. Niveli i çdo tubi do të përcaktohet gjithmonë me instrument topografik. Ky proces është i domosdoshëm për të garantuar vetërrjedhjen, shpejtësinë dhe prurjen e llogaritur në projekt. Më pas kanali mbushet përsëri me rërë të imët deri 20cm mbi pjesën e sipërme të tubit. Pas këtij procesi hidhen rikthime (dhé) në shtresa nga 30cm. Çdo shtresë duhet të ngjishet me rul. Kompaktësimi i shtresave (gjatë mbulimit të tubit) do të kryhet me tokmak elektrik (çdo 30cm), duke eliminuar goditjen direkte mbi tub në 30 centimetra e parë. Mbushja e kanalit dhe gjendja e mirë teknike e tij do të kontrollohet për të qenë sa më e rregullt në lidhje me qëndrueshmërinë dhe penetrimin. Tubat lidhen njëri pas tjetrit me gomina hermetizuese. Lidhja me ngjitje ose me gomina duhet të jetë në përshtatje me standardin dhe t'i rezistojë presionit 0,5 bar. Tubat gjatë transportit, shtrirjes dhe lidhjes nuk duhet të pësojnë deformime ose çarje. Gjatë vendosjes së tubacioneve duhet të kryhen matje topografike për të garantuar pjerrësitë e përcaktuara në projekt.

Materialet mbushëse nuk duhet të kenë gurë ose ndonjë material tjetër të fortë që ka dimensione 150 mm, në asnjë drejtim.

Kanalet në sipërfaqe do të jenë të risistemuar me materiale të njëjta si sipërfaqja origjinale e shtruar pasi Inxhinieri ka rënë dakord që instalimi është kompletuar. Anët e risistemimit do të priten në vija të drejta para se të jepet dora e fundit e rregullimit.

Atje ku është e mundur, do të përdoren materialet e zgjedhura nga germimi, dhe të hiqen gurët me madhësi mbi (>35mm) ose ndonjë objekt tjetër i fortë. Të gjithë materialet do të vendosen dhe do të ngjeshen me dorë ose me ngjeshës mekanik te përshtatshëm;

Fundi i kanalit duhet të jetë i qëndrueshëm.

Guarnicionet bashkues (n.q.s. aplikohet) DN (ID) 110 do të përdoren për lidhjen e tubacionit PVC DN (ID) 110, pra lidhjes së objektit me tubacionin kryesor DN (ID) 400, DN (ID) 300 dhe DN (ID) 200 dhe shërben për fiksimin dhe hermetizimin e tubit PVC me tubin e korruguar. Këndi i takimit të tubit PVC me tubin e korruguar do të jetë 90 gradë (deri + 30 gradë sipas drejtim të rrjedhës).

Tubat që do të përdoren duhet të jenë të pajisura me çertifikatat përkatëse që vërtetojnë cilësinë e tyre. Në figurën më poshtë paraqitet guarnicioni bashkues tip.

Pusetat e kontrollit b/a (1,5x1,5) m h=variabël

Do të realizohen prej betoni të armuar. Ato do të realizohen me beton të armuar duke lënë sipër një vrimë rrethore me diametër rreth 80cm e cila mbyllet me suport dhe kapak gize me diametër 60cm. Lartësia e pusëtës llogaritet duke mbetur kapaku i gizës në nivelin e sipërfaqes përfundimtare të shtresave të rrugës.

Në trupin e pusëtës do të inkastrohen shkallë metalike. Shkallët do të përbëhen nga shufra hekuri me diametër Ø20 dhe thellësia e inkastimit do të jetë 5 cm. Përmasat e shkallëve do të jenë (10x30) cm sipas detajeve të projektit të zbatimit.

Të gjitha punimet e betonit që do të kryhen për strukturat e pusetave, do të projektohen dhe ndërtohen në përputhje me standardet shqiptare.

Shufrat e armimit duhet të ruhen dhe duhet të mbrohen me materiale kundër ndryshkut, demtimeve, vajit ose agjentëve të tjerë shkatërrues.

Kontraktori do të jetë përgjegjës për kontrollin e të gjithë shufrave të kerkuara nga Inxhinieri dhe të japë garanci për saktësinë para prerjes dhe lidhjes së hekurit të armuar.

Përzjerrësit do të përdoren vetëm me një aprovim me shkrim të Supervizorit, me qëllim që të modifikohen karakteristikat e betonit dhe të arrihen rezultatet.

Markat e betonit të përdorura në punime do të jenë sipas kërkesës ose me këshillat e Supervizorit.

Kallëpet

Te gjithë skeletet, kallëpet, mbështetësit, dhe vend kalimet do të jenë të një cilësie të përshtatshme dhe me të tillë fortësi që të jenë përsëri rigjide pa lënë ndonjë shtrembërim ose ndryshim gjatë gjithë formës, gjatë vibrimit dhe ngjeshjes së betonit. Drurë ose dërrasa me një trashësi më të vogël se 20 mm nuk do të përdoren pa një aprovim specifik të Supervizorit. Të gjithë lidhjet e kallëpeve duhet të jenë me mbyllje të përshtatshme për të shmangur humbjen e materialeve të imta ose të llaçit gjatë hedhjes dhe konsolidimit të betonit. Forma e kallëpit duhet të jetë e projektuar e tillë që të mund të lejojë lëvizjen e tij pa dëmtuar betonin.

Kontraktori do të duhet të japë një njoftim Supervizorit 24 orë më parë për të hequr çdo kallëp. Pasi betoni është formuar, kallëpet duhet të hiqen me shumë kujdes, pa goditje ose ndonjë prishje, në mënyrë që betoni të mos të dëmtohet. Asnjë kallëp nuk duhet të hiqet para se betoni të jetë formuar plotësisht për të shmangur çdo prishje të strukturës së betonit.

Në përgjithësi, betoni do të konsolidohet me vibratorë elektrik ose pneumatik. Vibrimi i cili shkakton ndarje të përbërësve ose një sipërfaqe të ujëzuar, ose e cila sjell një sasi të madhe të njomjes në sipërfaqe duhet të shmanget. Për të gjithë llojet e pusetave bazamenti dhe kapaku prej gize duhet të jenë sipas standardit shqiptar.

Për të gjitha pusetat e kontrollit, për kapakët, rekomandohet tipi me ventilim, me menteshe, me diametër të jashtëm 610 mm dhe lartësi 100 mm.

Kapakët do të vendosen në nivelin dhe pjerrësinë përfundimtare të sipërfaqes së rrugës.

Nuk duhet të kryhen ndryshime të projektit gjatë zbatimit të tij. Në rastet kur është e domosdoshme duhet që këto të miratohen me shkrim nga klienti dhe supervizori i punimeve.

Standardet (Referencat)

Standardet e referencës janë ato shqiptare dhe standardet e vendeve të Bashkimit Europian EEC që konsiderohen si ekuivalente.

Sidoqoftë Sipërmarrësi për standardet që ai mendon të përdorë duhet më parë të bjerë dakord me Supervizorin përpara fillimit të punimeve.

Materialet dhe paisjet do të jenë sipas standardeve kombëtare ose ndërkombëtare të aprovuara.

Të gjitha materialet dhe komponentet përbërëse do të jenë të çertifikuara sipas standardeve Shqiptare dhe të gjitha prodhimet do të jenë konform Standardeve Kombëtare të ngjashme ose Kodet Praktike. Kontraktori mund të propozojë standarde alternative kombëtare të alternativave të propozuara të cilat duhet t'i paraqiten Supervizorit për rishikim dhe aprovim. Një kopje e të gjithë standardeve të aprovuara do të mbahen në kantier nga Kontraktori. Nëqoftëse nuk ka Specifikime të Standardeve të publikuara, materialet dhe prodhimet do të jenë nga standardet më të përshtatshme dhe do të jenë subjekt për aprovim nga Supervizioni. Kur punimet e propozuara lidhen me rrjetet ekzistuese materialet e reja do të jenë të përshtatshme me ato ekzistueset.

Paketimi për Transport, Ruajtja dhe magazinimi

Përpara dërgimit prej fabrikës në objekt të gjitha materialet do të jenë të mbrojtura mjaftueshëm me mënyra të aprovuara për të gjithë periudhën e tranzitit, magazinimit, si dhe të eliminohen demtime aksidentale. Kontraktori

do të jetë përgjegjës për paketimin nga fabrika, për mbrojtjen në mënyrë që materialet të arrijnë në vend të pa dëmtuara. Shkarkimi do të bëhet nga kontraktori (për shkarkimin e materialeve të furnizuara në vend ose magazinë) dhe ai është përgjegjës për ndonjë dëmtim.

Magazinimi në vend dhe mbajtja duhet të realizohen në mënyrë sa më të sigurt të jetë e mundur, dhe materialet që do të magazinohen të hapura në vend që të mos dëmtohen (Sigurimi i një magazine të aprovuar, mund të shihet si alternativë).

Ngarkimi dhe shkarkimi do të bëhen ngadalë me paisje të përshtatshme dhe tubacioni duhet të jetë nën kontroll gjatë gjithë kohës. Në asnjë rast nuk duhet që tubacioni të përplasë ose të hidhet nga lartësia. Në çdo rast duhet të përdoren rekomandimet e prodhuesit të tubave.

Inspektimi i Vendit

Para përgatitjes për të filluar punimet (nëse kërkohet) Kontraktori do të vizitojë Objektin dhe do të verifikojë gjendjen aktuale në krahasim me vizatimet e përgatitura, duke kontrolluar të gjithë dimensionet e rendësishme, rrugët e hyrjes, gjendjen e objektit dhe kërkesat në mënyrë që të sigurohet se të gjithë materialet dhe fuqia punëtore do të arrijë plotësisht sipas parashikimit të vizatimeve dhe Kontratës.

Përpara fillimit të punës Kontraktori do të ekzaminojë dhe të bëjë organizimin me Supervizionin që pajisjet të instalohen pa ndërhyrje me punët në vazhdim të konstruksionit dhe mund të shpërndajë në vend të gjitha materialet e listuara të kërkuara.

Kontraktori do të instruktrohet nga stafi i Supervizionit, për të marrë përgjegjësitë në të gjitha çështjet dhe gjërat që kanë të bëjnë me operimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e paisjeve dhe materialeve në kushte të përshtatshme.

Mbrojtja e shërbimeve dhe e veprave ekzistuese

Kontraktori do të njihet me pozicionin e të gjithë shërbimeve ekzistuese të tilla si rrjeti i ujësjellësit, lidhjet e banesave, sistemet ujitëse, drenazhet dhe kanalet e kullimit të ujrave sipërfaqësore, kabllat elektrike dhe të telefonit, shtyllat telefonike dhe të ndriçimit, tubacionet dhe të ngjashme me to përpara se të fillojë ndonjë gjërmim ose punë tjetër që mund të ndikojë këto shërbime. Kontraktori do të konsiderohet përgjegjës për dëmtimet e veprave dhe shërbimeve ekzistuese, dhe do të çdëmtojë Punëdhënësin për çdo ankesë në lidhje me këtë (duke përfshirë humbjet që pasojnë). Kontraktori do të jetë përgjegjës për risjelljen në gjendjen e mëparshme të shërbimeve që janë ndikuar.

Në të gjithë rastet kur këto vepra ose shërbime janë ekspozuar, ato duhet të mbrohen në mënyrë të përshtatshme, mbështeten ose mbrohen në ndonjë mënyrë tjetër.

Kujdes i veçantë duhet ushtruar në mbushjen dhe ngjeshjen e tokës nën tubacionet kryesore të rrjetit të ujësjellësit, kabllot, kanalet ujitëse etj. dhe të lihen të pa mbuluar çdo mates uji i ekspozuar, pusetë, valvol dhe të tjera si këto. Gjithë kostot që mund të rezultojnë nga Kontraktori si rezultat i punës programuese koordinuese për të bërë të mundur të bëhet çdo ndryshim këtyre shërbimeve, dhe kosto e çdo mase parandaluese do të gjykohen nga Supervizori nëse është e nevojshme, në sajë të afërsisë së veprave nga çdonjëra nga shërbimet e kontraktorit. Disa nga detajet e kryqëzimeve me infrastrukturën e lartpërmendur do të jepen me vizatime.

Shmangia e shërbimeve ekzistuese

Menjëherë pasi kërkesa është bërë e njohur, kontraktori do të jetë përgjegjës për organizimin, në bashkëveprim me autoritetet përkatëse, për lëvizjen ose alterimin (ndryshimin) e shërbimeve ekzistuese të tilla si linjat elektrike dhe telefonike, linjat kryesore të ujit të pijshëm, tubacionet, kanalet ujitëse, dhe drenazhet e ujit sipërfaqësor, të cilat ndikohen nga vepra. Organizimi për një lëvizje ose alterim (ndryshim) të tillë do të jetë me kusht të rënies dakord

me Supervizoin dhe me autoritetet përkatëse në zërat e çmimeve të preventivit; në këtë kuadër devijimi i shërbimeve ekzistuese nuk do të jetë subjekt i ndryshimit të çmimit total të kontratës.

Të gjitha materialet, punimet e tokës, shtrimi, lidhjet dhe rakorderitë dhe prova e tubacioneve do të plotësojnë me detaje të gjithë kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

Të gjitha materialet duhet të jenë të reja dhe të papërdorura.

Të gjitha tubat dhe rakorderitë duhet të jenë të inspektuara me kujdes, në kohën që arrijnë në objekt nga Kontraktori. Çdo material me difekt duhet të vendoset mënjanë për inspektim nga Supervizori; ato duhet ose të riparohen ose të zëvendësohen sipas instruksionit të dhënë nga Supervizori

Të gjithë difektet do të jenë të identifikuara dhe do të riparohen me shpenzimet e Kontraktorit.

NJËSIA E PROKURIMIT

- Thoma Koroveshi (Inxhinier Hidroteknik)

- Ilia Papa (Inxhinier Gjeodet)

- Grisilda Sejamini (Jurist)